

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përplasje Lavrov–Gjermani: A nuk kanë mësuar gjermanët nga Lufta e Dytë Botërore? - Informohu siç d uhet
ADRESA	https://radar.al/perplasje-lavrov-gjermani-a-nuk-kane-mesuar-gjermanet-nga-lufta-e-dyte-boterore/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 15:33:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 15:20:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c6259b9563af4648137fcda35550f00a82493f2e596bc00a4ceca3e76e221c2c
TEKSTI	34cde021bb7044df2e55163e48f66329c733b2c4b1691de992c94f687e18488b
PAMJA	641114e17d328e64590815a9d2af77a68072b663467721cb225ab465aed7d185

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bde41a852b1345420ca3f0e63f915623b05c33a9222e9aa13a4cb53619d709c8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9c79dfe18abd067ab8b189d0d92c4d66095ab349897e5facabd5b8506753a66f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/bde41a852b1345420ca3f0e63f915623b05c33a9222e9aa13a4cb53619d709c8

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Përplasje Lavrov-Gjermani: A nuk kanë mësuar gjermanët nga Lufta e Dytë Botërore?

BOTË

Demo

Përplasje Lavrov-Gjermani: A nuk kanë mësuar gjermanët nga Lufta e Dytë Botërore?

SEPTEMBER 27, 2026



Ministri i Jashtëm rus, Sergey Lavrov, ka hedhur poshtë thirrjet e homologut gjerman, Johann Wadephul, që Moska të heqë dorë nga "hapat e rrezikshëm përshkallëzues", duke akuzuar Berlinin se është një prej mbështetësve kryesorë të Ukrainës.

Lavrov dhe Wadephul u takuan në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, në një takim të paparalajmëruar më herët. Sipas palës ruse, ishte ministri gjerman ai që kërkoi zhvillimin e bisedimeve.

Takimi shënoi kontaktin e parë në nivel ministrash të Jashtëm mes Rusisë dhe Gjermanisë që prej vitit 2022, kur nisi pushtimi rus i Ukrainës.

Gjatë bisedimeve, Wadephul i bëri thirrje Moskës të heqë dorë nga "shtegu i rrezikshëm i përshkallëzimit", ndërsa shprehu gatishmërinë e Berlinit për përmirësimin e marrëdhënieve me Rusinë, nëse Kremli tregon vullnet për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë.

Lavrov iu përgjigj publikisht këtyre qëndrimeve, duke kritikuar deklaratat e kancelarit gjerman Friedrich Merz për forcimin e kapaciteteve ushtarake të Gjermanisë.

"Kancelari Merz thotë se Gjermania duhet të jetë sërish fuqia e parë ushtarake në Evropë. A e kupton Berlini se çfarë mund të sjellë kjo? Nuk kanë mësuar gjë gjermanët nga leksionet e Luftës së Dytë Botërore?", deklaroi Lavrov.

Pas fjalimit, në një konferencë për mediat, kryediplomati rus u pyet për takimin me homologun gjerman dhe mundësinë e dialogut mes dy vendeve.

"Asgjë e re nuk erdhi nga nisma e ministrit të Jashtëm. Ai thjesht përsëriti qasjen e tij publike, duke dënuar Rusinë. Ju mund ta gjykonë vetë nëse kjo vlen për dialog apo jo", tha Lavrov.

Marrëdhëniet mes Berlinit dhe Moskës janë përkeqësuar ndjeshëm që prej nisjes së luftës në Ukrainë. Në fillim të shtatorit, Gjermania akuzoi Rusinë për përfshirje në sulmin me dron ndaj aeroportit të Lajpcigut në gusht.

Berlini njoftoi më pas masa të reja ndaj Moskës, përfshirë mbylljen e konsullatës ruse në Bon dhe të qendrës kulturore ruse në Berlin, të cilën autoritetet gjermane e kanë konsideruar si të lidhur me veprimtari spiunazhi.

Gjermania ka paralajmëruar gjithashtu kontrolle më të forta kufitare për shtetasit rusë dhe rritje të presionit ndaj të ashtuquajturës "flota hije" e Rusisë.

Postimet e reja

Përplasje Lavrov-Gjermani: A nuk kanë...

SEPTEMBER 27, 2026

Dhuna me Bazë Gjinore në politikë, faktor dekuraju...

SEPTEMBER 27, 2026

Rama: Në asnjë vend të mbytur nga korrupsioni,...

SEPTEMBER 27, 2026

"Penalltia na theu psikologjikisht", kapiteni...

SEPTEMBER 27, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç 'Delvina Gas' ai...

ALERT në Sloveni për VIPA
Flips të Kosovës, kanë përmbytje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Na ndiq

